



Prishtinë, 13 qershor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_977_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 1.19 dhe 1.51, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4, Nenit 39, 40 dhe 41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitave të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- Dispozitave të Nenit 17 të Licencës për Furnizim me Energji elektrike dhënë "KESC" J.S.C;
- Vendimit të ZRRE V_976_2018 të datës 13.04.2018 për Hapjen e Procedurës së Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

në seancën e mbajtur më 13 Qershor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT


- I. Caktohet "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C, që të ushtrojë PËRKOHËSISHT obligimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar).
- II. Obligimi i caktuar në paragrafin I të këtij Vendimi do të ushtrohet për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh, dhe fillon të zbatohet nga data 13 Qershor 2018 deri më datën 13 Dhjetor 2018.
- III. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit të përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit dhe Licencën për Furnizim me energji elektrike të lëshuar nga ZRRE.
- IV. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
 - furnizuesi i tij ka bankrotuar apo është në likuidim;
 - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar;
 - konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

- V. Furnizimi i garantuar sipas pikës IV nuk mund të zgjasë më shumë se **gjashtëdhjetë (60) ditë**.
- VI. **Kostot e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të përcaktohen në përputhje me Nenin 6 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.**


ARSYETIM

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me dispozitat e Nenit 40 të Ligjit për energjinë Elektrike, me Vendimi V_976_2018, me datë 28 prill 2018 ka bërë shpalljen e Tenderit për të zgjedhur furnizuesin të cilit do i ngarkohet obligimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
2. Në tenderin e shpallur ZRRE nuk ka pranuar asnjë aplikacion nga Furnizuesit aktual të licencuar, andaj në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitivin e këtij Vendimi.
- VII. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi i dërgohet:
"KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C,
Aktivit të Rregullatorit